



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

---

Nr 61 prot.

Tiranë, më 15.04 2010

**VENDIM Nr. 71, dt. 06.04.2010**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), të VKM Nr. 725, datë 21.05.2008, "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë", Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 06.04.2010,

**VENDOSI:**

- I. Bazuar në vëzhgimin intensiv arkeologjik realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës, të miratojë projektin "Studim Pjesor në Porto – Romano", "Për ndërtimin e Terminalit të Nënprodukteve të Naftës" nga subjekti ndërtues "CROWN ACQUISITIONS":
  1. Është e domosdoshme prezenca e ekspertëve arkeologë gjatë zbatimit të punimeve.
  2. Punimet për këtë terminal edhe pse nuk është vërejtur potencial arkeologjik, do të mbikqyren nga ekspertë arkeologë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës.
  3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
FERDINAND XHAFERAJ

SEKRETARI I KKA  
ROLAND OLLI

